



TEMPULLI

Rr. Eduard Lir 158, Arbëria
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: 038 22 22 55, 038 60 40 20
Fax: 038 60 40 19
Web: www.tempulli.org
Email: info@tempulli.org



Kryesuesi i Këshillit Akademik

Prof. Dr. sc. Mevlan Bixhaku

Në bazë të të Statutit të Kolegjit Tempulli dhe nenit 3, paragrafi 1.9 të rregullores së punës së Këshillit Akademik në mbledhjen e mbajtur më 07.05.2025 Këshilli Akademik miratoj këtë:

RREGULLORE PËR ALUMNI

Neni 1: Qëllimi

Kjo rregullore përcakton mënyrën e organizimit, funksionimit dhe qëllimin e Rrjetit Alumni të Kolegjit Tempulli, me synim ruajtjen e marrëdhënieve të qëndrueshme me ish-studentët dhe promovimin e bashkëpunimit profesional e akademik.

Neni 2: Anëtarësimi

1. Anëtarë të rrjetit alumni janë të gjithë ish-studentët e Kolegjit Tempulli që kanë përfunduar me sukses një program studimi.
2. Anëtarësimi është i hapur dhe pa pagesë.
3. Anëtarësimi formalizohet përmes regjistrimit në databazën zyrtare të zyrës për alumni.

Neni 3: Qëllimet e Rrjetit Alumni

1. Të ruajë lidhjet me ish-studentët përmes aktiviteteve sociale, profesionale dhe akademike.
2. Të përfshijë alumnit në zhvillimin e programeve akademike dhe trajnimeve profesionale.
3. Të ndihmojë studentët aktualë përmes mentorimit dhe rrjetëzimit profesional.
4. Të promovojë vlerat dhe imazhin e Kolegjit në komunitet dhe në tregun e punës.

Neni 4: Organizimi dhe Koordinimi

1. Rrjeti Alumni koordinohet nga Zyra për Karrierë
2. Mund të krijohen grupe pune ose bord këshillues të përbërë nga anëtarë të alumnive për të ndihmuar në organizimin e aktiviteteve.
3. Zyra për Karrierë mban dhe mirëmban databazën e alumnive, njoftimet dhe komunikimin me ta, duke i njoftuar për mundësi të ndryshme karriere dhe zhvillimi profesional.

Neni 5: Aktivitete të Rrjetit Alumni

1. Organizimi i takimeve vjetore dhe ngjarjeve profesionale.
2. Pjesëmarrja e alumnive në tryeza, ligjërata, trajnime dhe panairë të karrierës.
3. Krijimi i platformave online për rrjetëzim dhe ndarjen e përvojave.
4. Publikimi i buletinit vjetor të alumnive me histori suksesi dhe njoftime.

Neni 6: Bashkëpunimi me Institucionin

1. Alumnit mund të kontribuojnë me ide, këshilla dhe propozime për zhvillimin institucional.
2. Institucioni mund të ftojë alumnit për përfaqësim në takime apo panele strategjike.
3. Kontributi i alumnive njihet dhe promovohet nga Kolegji Tempulli.

Neni 7: Dispozita Përfundimtare

1. Kjo rregullore miratohet nga Këshilli Akademik i Kolegjit Tempulli.
2. Çdo ndryshim në rregullore propozohet nga Zyra për Karrierë dhe miratohet nga Këshilli Akademik.
3. Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kryesuesi i Këshillit Akademik
Prof. Dr. sc. Mevlan Bixhaku

